



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

LICENCË

PËR VEPRIMTARINË E OPERIMIT NË IMPIANTET E GNL-SË

Numri i licencës:

Seria:

Shoqëria:

NUIS-i:

Data e hyrjes në fuqi:

Kohëzgjatja:

Kushte të tjera:

Bazuar në autoritetin që i është dhënë në seksionin e dytë të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) i jep këtë licencë operimi në impiantet e GNL-së, (licenca), për të kryer aktivitetin e operimit në impiantet e GNL-së, personit të lartpërmendur, i quajtur (i licencuari), subjekt i kushteve të kësaj licence, si dhe kushteve të përcaktuara në Vendimin e Bordit të ERE-s nr. __, datë __.__.__. Kjo licencë hyn në fuqi në datën e shkruar më lart dhe do të vazhdojë të jetë në fuqi për një periudhë prej __ vjetësh, në rast se nuk përfundohet ose pezullohet nga ERE, në përputhje me kushtet e licencës të përfshira këtu.

[Kryetari]

[Vula e ERE-s]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

KUSHTET E LICENCËS

PËR VEPRIMTARINË E OPERIMIT NË IMPIANTET E GNL-SË

Numri i licencës: _____

I jepet: _____
(emri i plotë i të licencuarit)

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

1. ERE është autoriteti i vetëm në Republikën e Shqipërisë, i njohur sipas ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, që lëshon dhe deklaron hyrjen në fuqi të kësaj licence.
2. Nëse ndonjë kusht i kësaj licence pushon së qeni efektiv, ai kusht do të hiqet nga kushtet e licencës dhe kushtet e mbetura do të vazhdojnë të jenë në fuqi.
3. Kjo licencë mund të transferohet, tërësisht ose pjesërisht, vetëm me vendim të ERE-s dhe sipas afateve dhe kushteve të vendosura nga ERE. Kur miraton një transferim, ERE mund ta modifikojë periudhën e licencës ose kushtet e tjera të licencës pasi të ketë arsyetuar vendimmarrjen.
4. ERE ndryshon licencën në përputhje me nenin 28, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, si dhe parashikimet e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, në rastet e mëposhtme:
 - a) me iniciativën e vet;
 - b) në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë;
 - c) kur ndryshojnë kushtet, për të cilat është dhënë licenca;
 - d) me kërkesën e të licencuarit.

5. I licencuari mund të kërkojë një modifikim të kësaj licence nëpërmjet një kërkesë të detajuar me shkrim, si dhe dokumentacionit mbështetës, në përputhje me ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, si dhe “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”.
6. Përkufizimet e termave të përcaktuar në këtë dokument do të kenë kuptimin e parashikuar në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

Neni 2

Kryerja e aktivitetit të licencuar

1. I licencuari autorizohet nga kjo licencë për kryerjen e veprimtarisë së licencuar.
2. I licencuari nuk do të bashkëpunojë në asnjë mënyrë me të licencuar të tjerë lidhur me veprimtarinë e licencuar në dëm të tregtuesve, furnizuesve ose klientëve dhe përdoruesve ekzistues ose të mundshëm.
3. I licencuari nuk do të angazhohet në kryerjen e veprimeve ose në ndonjë aktivitet tjetër që përbën sjellje antikonkurrese sipas legjislacionit në fuqi.
4. I licencuari nuk do të angazhohet në veprimtari të tjera, që pengojnë ose mund të pengojnë kryerjen si duhet të veprimtarisë së licencuar. I licencuari do të njoftojë ERE-n para se të ndërmarrë ndonjë veprimtari, përveç veprimtarisë së licencuar.
5. I licencuari nuk do të pengojë, parandalojë ose të përpiqet të parandalojë të licencuar të tjerë apo konkurrues potencialë që të angazhohen ligjërisht ose të hyjnë në biznesin e gazit natyror në Republikën e Shqipërisë.
6. Gjithë marrëveshjet për ofrimin e shërbimit të operimit në impiantet e GNL-së duhet të përputhen me legjislacionin në fuqi për aq sa kërkohet nga këto të fundit.
7. Të gjitha marrëveshjet do të jenë objekt monitorimi nga ERE për të siguruar funksionimin e tregut dhe që të licencuarit nuk ushtrojnë ndikim mbi tregun, duke ndjekur praktika të padrejta dhe që bien ndesh me legjislacionin për konkurrencën.

Neni 3

Detyrimet e të licencuarit

1. I licencuari do të respektojë legjislacionin në fuqi gjatë ushtrimit të funksioneve sipas kësaj licence.
2. I licencuari, gjatë ushtrimit të funksioneve sipas kësaj licence, ka detyrime si vijon:

- a) do të ndërmarrë masat e nevojshme për garantimin e aftësive teknike dhe financiare për kryerjen e aktivitetit të licencuar.
- b) do të regjistrohet si pjesëmarrës i tregut shqiptar të gazit natyror pranë operatorit të tregut të gazit natyror, sipas procedurave të regjistrimit dhe do të zbatojë legjislacionin në fuqi dhe vendimet e ERE-s.
- c) do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për përmirësimin e eficiencës operative dhe ekonomike të veprimtarisë së licencuar, me qëllim që të sigurojë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve të ofruara prej tij në përfitim të klientëve dhe të sektorit të gazit natyror.
- d) do të përmbushë gjithë rregullat e operatorit të sistemit të transmetimit të miratuara nga ERE, përfshirë zbatimin e gjithë urdhrave operativë, udhëzimeve, si dhe paraqitjen e informacionit teknik dhe gjithë dokumentacionit tjetër, sipas kërkesave të Kodit të Rrjetit të Transmetimit të Gazit Natyror dhe rregullave të tregut të gazit natyror.
- e) do të operojë, mirëmbajë dhe zhvillojë një impiant GNL-je të sigurt, të qëndrueshëm dhe eficient, për të siguruar një treg të hapur, duke marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e mjedisit, si dhe do të garantojë mjete të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e shërbimit;
- f) do të lidhë impiantin e GNL-së me sistemin e transmetimit, në përputhje me rregullat teknike të sistemit të transmetimit dhe me rregullat për përdorimin e impianteve të GNL-së;
- g) do të vendosë një sistem matës të rrjedhave hyrëse dhe dalëse, si dhe të parametrave të cilësisë së gazit;
- h) do të shkarkojë dhe rigazifikojë GNL-në, sipas kontratave të nënshkruara;
- i) do të sigurojë kushte objektive, të njëjta dhe jodiskriminuese, për akses në impiantin e GNL-së, sipas kushteve të përgjithshme të furnizimit me gaz natyror, të miratuara nga ERE, sipas neneve 16 e 75 të ligjit nr. 102/2015, i ndryshuar;
- j) do të kufizojë diskriminimin ndërmjet përdoruesve ose grupeve të përdoruesve të sistemit, sidomos kur ky diskriminim favorizon shoqëritë e lidhura;
- k) do të përgatisë një plan pesëvjeçar për zhvillimin e impiantit të GNL-së, të cilin e publikon, e përditëson çdo vit dhe e paraqet për miratim në ERE;
- l) do t'i sigurojë çdo operatori tjetër të sistemit informacion të mjaftueshëm, për të garantuar që transportimi dhe depozitimi i gazit natyror të bëhen në përputhje me operimin e sigurt dhe eficient të sistemeve të ndërlidhura;
- m) do të sigurojë paraprakisht, brenda një afati të arsyeshëm, informacion të rregullt për pjesëmarrësit e tregut të gazit, për vëllimin dhe datën e mbylljes së operimit të impiantit të GNL-së dhe reduktimin e pritshëm të kapaciteteve të impiantit të GNL-së;

- n) do të mbrojnë informacionin konfidencial, me natyrë tregtare, të marrë gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij;
- o) do të vendosë në dispozicion të gjithë informacionin, në përputhje me nenin 73, të ligjit nr. 102/2015, të ndryshuar, për një periudhë prej 5 vjetësh, për ERE-n, ministrinë përgjegjëse, Autoritetin e Konkurrencës, si dhe çdo autoritet tjetër përgjegjës. Ky informacion i vihet në dispozicion Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë;
- p) do të marrë masa të arsyeshme për të lejuar që të drejtat e kapaciteteve të jenë lirisht të tregtueshme, për të lehtësuar që ky proces të kryhet në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese;
- q) do të nxisë lidhjen e kontratave dhe procedurave të harmonizuara me impiante GNL-je për tregun primar, për të lehtësuar tregun sekondar të kapaciteteve, dhe lejon njohjen e transferimit të të drejtave të kapacitetit fillestar, kur kjo është njoftuar nga përdoruesit e sistemit. Këto kontrata dhe procedura të harmonizuara i bëhen me dije ERE-s.

Neni 4

Llogaritë dhe raportimi

1. I licencuari do të mbajë regjistra llogarie dhe do të përgatisë bilance financiare konform legjislacionit në fuqi dhe standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit. I licencuari do t'i dorëzojë ERE-s bilancet financiare vjetore, së bashku me raportet e auditit, brenda datës 31 mars të çdo viti. I licencuari mban llogari të veçanta financiare për veprimtari të tjera të gazit, të cilat mund të jenë të konsoliduara, duke mbajtur të ndara edhe llogaritë që nuk lidhen me veprimtaritë e parashikuara në këtë ligj.
2. I licencuari mban llogari të veçanta për secilën nga veprimtaritë e licencuara që ushtron, si dhe për çdo veprimtari tjetër që nuk lidhet me sektorin e gazit natyror, me qëllim shmangien e ndërsubvencionimit dhe cenimit të konkurrencës. Këto llogari mund të paraqiten të konsoliduara, përveç rastit kur veprimtaritë e kryera lidhen me shpërndarjen apo transmetimin e gazit natyror.
3. I licencuari do t'i paraqesë ERE-s, me kërkesën e saj dhe sipas formës dhe brenda kohës së vendosur nga ERE, çdo informacion që është i domosdoshëm për ERE-n për të kryer përgjegjësitë e saj rregullatore të autorizuara.
4. ERE mund të vërë në dispozicion të pjesëmarrësve të tregut të dhëna të caktuara, të deklaruara nga i licencuari, me kusht që të mos publikohet informacioni që përbën sekret tregtar.
5. I licencuari do të njoftojë ERE-n, brenda 10 ditëve, për çdo ndryshim të:
 - a) adresës zyrtare përfshirë dhe atë elektronike
 - b) statutit të të licencuarit;
 - c) certifikatës së regjistrimit;

- d) NUIS-it;
 - e) drejtuesve të lartë.
6. Të gjitha njoftimet zyrtare, aplikimet, peticionet, deklaratat ose korrespondenca tjetër me ERE-n, lidhur me detyrimet sipas kësaj licence, duhet të jenë me shkrim, duke caktuar respektivisht nga një zyrtar të autorizuar ose përfaqësues tjetër të të licencuarit ose të ERE-s. Këto dërgohen me korrier ose postë të regjistruar, duke kërkuar një verifikim të fletës së marrjes. Adresat e palëve duhet të vendosen mbi zarf. Gjithë njoftimet ose korrespondenca tjetër do të konsiderohen se hyjnë në fuqi nga momenti i dorëzimit ose nëse nuk janë dorëzuar për shkak të gabimit të dërguesit, nga momenti i prezantimit. Do të konsiderohen të pranuar edhe gjithë njoftimet e dërguara përmes postës elektronike zyrtare të komunikuar më parë nga palët.

Neni 5

Përdorimi i informacionit

1. Sipas ligjit, Kodit të Transmetimit, Kodit të Shpërndarjes, “Rregullave të tregut të gazit natyror” dhe kërkesave të rregulloreve përkatëse, i licencuari do të sigurojë që çdo informacion i marrë nga të tjerët si rezultat i veprimtarisë së tij të licencuar, nuk do t’i jepet askujt, përveç rasteve kur:
 - a) ka pëlqimin paraprak me shkrim të personit me çështjet e të cilit lidhet informacioni;
 - b) informacioni është tashmë i njohur për publikun;
 - c) kur të licencuarit i kërkohet ose i lejohet ta përhapë informacionin për të përmbushur kushtet e kësaj licence, çdo urdhër të ERE-s dhe legjislacionit në fuqi.
2. Me kërkesën e ERE-s, i licencuari do të ndërmarrë çdo hap të nevojshëm për ta mbrojtur informacionin konfidencial që posedon dhe do t’i paraqesë ERE-s raporte që lidhen me respektimin e detyrimeve të parashikuara në nenin 7.
3. Informacioni që i sigurohet ERE-s nga i licencuari do të konsiderohet publik, përveç kur me kërkesë të veçantë të të licencuarit, ERE, me vendim, siguron se ky informacion është i natyrës pasurore dhe se interesi publik të cilit i shërbehet nga përhapja e tij nuk do ta justifikojë ose kompensojë dëmin komercial potencial ndaj të licencuarit.

Neni 6

Pagesat e rregullimit

1. I licencuari do të paguajë pagesën e rregullimit në mënyrën e përcaktuar nga ERE gjatë afatit të kësaj licence, në përputhje me nenin 14, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.
2. Nëse i licencuari nuk i paguan ERE-s pagesat e rregullimit brenda afatit të kërkuar nga ERE, ndaj të licencuarit do të merret masë administrative, në përputhje me nenin 106, të ligjit nr. 102/2015, “Për

sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, si dhe “Rregulloren mbi kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje”.

Neni 7

Kontrolli mbi performancën e veprimtarisë së licencuar

1. ERE do të monitorojë respektimin nga i licencuari të kushteve të licencës, do të rishikojë raportet e marra nga i licencuari dhe është e autorizuar që të inspektojë në çdo kohë regjistrat financiarë të të licencuarit dhe mund të kërkojë një auditim teknik dhe/ose financiar të veprimtarive të të licencuarit.
2. Përfaqësuesit e autorizuar të ERE-s mund të hyjnë në ambientet, pajisjet dhe dokumentet e të licencuarit për të inspektuar veprimtarinë e licencuar sipas rregullave të ERE-s. I licencuari do të japë çdo ndihmë të kërkuar nga ERE gjatë këtij inspektimi.
3. Në bazë të ankesës së konfirmuar të çdo pale të tretë ose me iniciativën e vet, ERE mund të nisë një hetim administrativ për respektimin nga i licencuari të kushteve të licencës ose rregullave të ERE-s.
4. Nëse pas hetimit, ERE konkludon se i licencuari nuk i ka respektuar kushtet e licencës, ERE mundet të ndërmarrë masa të tjera brenda autoritetit të saj, me qëllim që të sigurojë përmbushjen e afateve dhe kushteve të kësaj licence.
5. I licencuari do ta informojë dhe do ta sqarojë ERE-n për çdo shkelje të kushteve të licencës, jo më vonë se një javë pasi kjo shkelje i bëhet e njohur të licencuarit.
6. I licencuari do t’u bindet vendimeve të nxjerra nga ERE, përfshirë pagesat e gjobave të vëna nga ERE, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 8

Vendosja e masave administrative dhe heqja e licencës

1. Nëse i licencuari nuk përmbush kushtet e kësaj licence, ERE mund të aplikojë masa administrative, sipas nenit 106, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” , të ndryshuar.
2. ERE mund të heqë licencën në përputhje me nenin 27, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, dhe “Rregulloren për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, si dhe në rastet e tjera të parashikuara në këtë licencë.
3. ERE heq një licencë kur i licencuari:
 - a) nuk përmbush më kushtet thelbësore të licencës;
 - b) shkel dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij;
 - c) rrezikon jetën, shëndetin dhe pasurinën e qytetarëve;

- d) nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE;
 - e) bëhet financiarisht i paafte ose kërkon shpalljen e falimentimit;
 - f) ka bërë kërkesë për heqje licence;
 - g) ka pushuar së kryeri funksionet e caktuara sipas licencës.
4. Nëse i licencuari ndryshon statusin e tij ligjor ose aksionari kryesor/ortaku që kontrollon interesat e të licencuarit ndryshohet pa autorizim nga ERE, atëherë ai do të jetë subjekt i vendosjes së masave administrative në bazë të nenit 106 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, deri në heqjen e licencës, në përputhje me përcaktimet e “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”.
 5. Çdo transferim i kësaj licence, pa miratimin e ERE-s, do të anulohet dhe do të përbëjë një shkelje të kësaj licence.
 6. Kur licenca përfundon si pasojë e shkeljeve nga i licencuari të kushteve të licencës, i licencuari do të përgjigjet për koston që i shkakton ERE-s dhe pjesëmarrësve të tregut si rezultat i këtij përfundimi, siç përcaktohet nga ERE, përfshirë kostot lidhur me transferimin e rregullt të licencës te një i licencuar i ri.
 7. Kur ERE konstaton se i licencuari ka shkelur një ose më shumë kushte të licencës, të licencuarit mund t’i jepet një mundësi e arsyeshme për ta korrigjuar shkeljen para përfundimit të licencës, përveç kur shkelja përfshin korrupsion ose pandershmeri të vërtetuara nga organet me autoritetin përkatës, sipas ligjeve në fuqi.
 8. Në rastet kur ERE merr vendim për heqjen e një licence të të licencuarit që ushtron veprimtarinë e operimit të GNL-së, ndaj të cilit është vendosur detyrimi i shërbimit publik, në mënyrë që asetet, pronë e të licencuarit, të vazhdojnë të shfrytëzohen për sigurinë e furnizimit të gazit natyror ndaj klientëve, ERE, bazuar në rregulloren përkatëse të procedurave të heqjes së licencës, vendos një nga masat e përkohshme, të përcaktuara në nenin 27, pika 3 të ligjit.

Neni 9

Situatat e emergjencës

1. I licencuari nuk do të konsiderohet se ka shkelur kushtet e kësaj licence në rast se parandalohet në përmbushjen e tyre nga forca madhore ose rrethana të tjera emergjence.
2. Në kushtet e emergjencës, i licencuari:
 - a) do të sigurojë bashkëpunimin e nevojshëm me autoritetet dhe institucionet përgjegjëse për të vepruar në situatë emergjence, me qëllim që të rifillojë veprimtarinë brenda një periudhe kohore sa më të shkurtër;

- b) do të plotësojë detyrimet e tij për reduktimin e rreziqeve dhe humbjeve lidhur me jetën, shëndetin dhe pronën e palëve të treta;
 - c) brenda 24 orëve nga ngjarja e emergjencës, i licencuari do të njoftojë ERE-n për situatën e emergjencës dhe veprimet që do të ndërmerret për të rifilluar veprimtarinë normale.
3. Nëse i licencuari e parashikon situatën e emergjencës, siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi, i licencuari do të njoftojë ERE-n brenda 24 orëve, dhe ky njoftim do të përshkruajë se çfarë hapash do të marrë i licencuari për të mënjanuar ose për të përmirësuar ndikimet e situatës emergjente të parashikuara.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe e drejta për ankim

1. Çdo çështje e diskutueshme ose pretendim mes të licencuarit dhe çdo pjesëmarrësi në treg lidhur me kushtet e licencës dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi do të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.
2. Nëse zgjidhja nuk arrihet me mirëkuptim midis palëve, në bazë të kërkesës së një prej palëve në mosmarrëveshje, ERE do ta zgjidhë mosmarrëveshjen dhe do të nxjerrë vendimin e tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Çdo palë në konflikt mund të ankimojë vendimet e ERE-s në Gjykatën Administrative, Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga data e publikimit të vendimit në Fletoren Zyrtare.
4. Subjektet e licencuara do të zbatojnë vendimet e ERE-s, deri në një vendim gjykate të formës së prerë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

LICENCË

PËR VEPRIMTARINË E OPERIMIT NË IMPIANTET E GNL-SË

Licenca i jepet:

(emri i plotë i të licencuarit)

Seria: _____ Nr. i licencës: _____

Data e hyrjes në fuqi të kësaj shtojce: _____

ANEKS

TË DHËNA TEKNIKE